

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission in  
Kosovo



**UNMIK**

**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

UNMIK/REG/2008/4  
5 shkurt 2008

---

**RREGULLORE NR. 2008/4**

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2002/13 MBI  
THEMELIMIN E DHOMËS SË POSAÇME NË GJYKATËN SUPREME TË  
KOSOVËS MBI ÇËSHTJET QË KANË TË BËJNË ME AGJENCINË KOSOVARE  
TË MIRËBESIMIT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Pas konsultimit të Këshillit Ekonomik dhe Fiskal dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2002/13 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme në Gjykatën Supreme të Kosovës mbi çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/18 të datës 22 prill 2005 për ndryshimin e Rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2002/12 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit,

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të mbikëqyrjes gjyqësore efektive të punës së Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës,

Me anë të kësaj ndryshon preambulën dhe nenet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 14 të Rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2002/13,

Si pasojë, Rregullorja ndryshohet si më poshtë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje:

## RREGULLORE NR. 2008/4

### MBI THEMELIMIN E DHOMËS SË POSAÇME NË GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovës (UNMIK) të datës 25 korrik 1999, mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe nenin 8.1(u) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të rritjes së kapacitetit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për të gjykuar ankesat që kanë të bëjnë me vendimet ose veprimet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/18 të datës 22 prill 2005, dhe çështjeve të tjera të tilla që mund t'iu referohemi sipas ligjit,

Me anë të kësaj shpall:

#### Neni 1

#### Themelimi i Dhomës së Posaçme

1.1 Me anë të kësaj Rregulloreje themelohet Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (më tej “Dhoma e Posaçme”).

1.2 Selia e Dhomës së Posaçme do të jetë në Prishtinë, përveç rasteve kur Dhoma e Posaçme vendos të mblidhet diku tjetër, për të shqyrtuar një rast të caktuar.

#### Neni 2

#### Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

(a) “Agjenci” do të thotë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit:

- (b) “Ligj në fuqi” do të thotë ligji i zbatueshëm në Kosovë, në përputhje me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi ligjin në fuqi, të datës 2 dhjetor 1999;
- (c) “Korporatë” ka kuptimin e përcaktuar në Rregulloren e ndryshuar nr. 2002/12;
- (d) “Ndërmarrje” ka kuptimin e përcaktuar në Rregulloren e ndryshuar nr. 2002/12;
- (e) “Aktgjykim” ka kuptimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve në një rast;
- (f) “Vendim” ka kuptimin e çfarëdo vendimi të gjykatës dhe përfshin aktvendimin ose urdhrin; dhe
- (g) “Rregullore nr. 2002/12” ka kuptimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e ndryshuar kohë pas kohe.

Fjalët e njëres gjinie të përdorura në këtë Rregullore përfshijnë edhe gjininë tjetër dhe fjalët në numrin njëjës nënkuptojnë edhe shumësin dhe shumësi gjithashtu përfshin edhe njëjësin.

### Neni 3 Përbërja

3.1 Dhoma e Posaçme përbëhet nga njëzet (20) gjyqtarë, nga të cilët trembëdhjetë (13) do të jenë gjyqtarë ndërkombëtarë dhe shtatë (7) banorë të përhershëm të Kosovës. Njëri prej gjyqtarëve ndërkombëtarë do të caktohet për të shërbyer si kryetar në Dhomën e Posaçme nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i cakton gjyqtarët që të shërbejnë në Dhomën e Posaçme. Gjyqtarët të cilët janë banor të përhershëm të Kosovës do të caktohen pas konsultimeve me Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

3.2 Nga radhët e gjyqtarëve të caktuar për të shërbyer në Dhomën e Posaçme dhe të cilët janë në dispozicion Kryetari i Dhomës së Posaçme do të caktojë një apo më shumë grupe nga dy gjyqtarë ndërkombëtarë dhe një gjyqtar i cili është banor i përhershëm i Kosovës, çdonjëri për të shërbyer në njërin prej pesë paneleve prej tri gjyqtarësh, të themeluar për drejtimin e gjykimeve dhe për marrjen e vendimeve gjyqësore mbi kërkesat dhe kundërkërkesat në shkallën e parë. Çdo panel i themeluar në mënyrën e tillë do të jetë i specializuar në njërin nga fushat vijuese dhe do të kryesohet nga një gjyqtar ndërkombëtar i specializuar në fushën e njëjtë:

- (a) çështjet që lidhen me privatizimin;
- (b) çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve sipas nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13 të ndryshuar kohë pas kohe;
- (c) kërkesat e përgjithshme mbi pronësinë dhe ato të kreditorëve;

- (d) çështjet që lidhen me likuidimin e ndërmarrjeve dhe
- (e) riorganizimi i ristrukturimit të ndërmarrjeve në pajtim me Rregulloren nr. 2005/48 të ndryshuar kohë pas kohe;

rregullat procedurale të shpallura me nenin 7 do t'i caktojnë detajet tjera.

3.3 Kryetari i cili vepron në pajtim me rregullat procedurale të shpallura me nenin 7 të kësaj Rregulloreje gjithashtu do të caktojë dy gjyqtarë ndërkombëtarë dhe dy gjyqtarë të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës si gjyqtarë të apelit, të cilët së bashku me Kryetarin e Dhomës së Posaçme i cili ushtron funksionin e kryetarit përbëjnë panelin e apelit:

(a) mbi të gjitha çështjet për të cilat është paraqitur apel tek ai, paneli i apelit do të ulet si panel me jo më pak se tre gjyqtarë, shumica e të cilëve do të jenë gjyqtarë ndërkombëtarë.

(b) Kryetari i Dhomës së Posaçme në pajtim me rregullat procedurale sipas nenit 7 të kësaj Rregulloreje mund të caktojë anëtarë të panelit gjyqësor që të marrin pjesë në panelin e apelit dhe mund të caktojë një anëtar të panelit të apelit që përkohësisht të merr pjesë në panelin gjyqësor. Ai gjithashtu mund të delegojë edhe funksionin e kryetarit në panelin e apelit.

3.4 Me rastin e caktimit në detyrë të gjyqtarëve që janë banorë të Kosovës, kujdes i veçantë do t'i kushtohet përdorimit të gjuhëve të komuniteteve, ashtu siç është përcaktuar në ligjin në fuqi.

3.5 Nëse një gjyqtar është i paaftë të kryejë detyrat e tij, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Supreme, cakton një gjykatës tjetër zëvendësues.

#### Neni 4 Juridiksioni

4.1 Panelet gjyqësore të Dhomës së Posaçme kanë juridiksion parësor për kërkesat dhe kundërkërkesat që lidhen me:

- (a) Kundërshtimet ndaj vendimeve ose veprimeve të tjera të Agjencisë, të marra në përputhje me Rregulloren nr. 2002/12, duke përfshirë shqiptimin e gjobave, siç është përcaktuar në nenin 27 të Rregullores nr. 2002/12;
- (b) Paditë kundër Agjencisë për humbjet financiare që rezultojnë nga vendimet apo veprimet e marra në përputhje me kompetencat e saj si administruese e një ndërmarrjeje apo korporate;
- (c) Paditë, duke përfshirë paditë e kreditorëve ose paditë pronësore, të bëra kundër një ndërmarrjeje apo korporate, që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin administrues të Agjencisë, kur këto padi kanë lindur gjatë, ose para se ndërmarrja apo

korporata e tillë t'i jetë nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë;

(d) Paditë që përfshijnë njohjen e një të drejte, një titulli apo interesi pronësor, që është në posedim apo nën kontrollin e një ndërmarrjeje a korporate, që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin administrues të Agjencisë, kur paditë e tilla kanë lindur gjatë ose para kohës kur ndërmarrja apo korporata e tillë i është nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë;

(e) Paditë që kanë të bëjnë me listën zyrtare të punëtorëve që kanë të drejtë të një ndërmarrjeje të nxjerrë nga agjencia dhe punëtorët që kanë të drejtë sipas nenit 10 të Rregullores së ndryshuar nr. 2003/13;

(f) Paditë që kanë të bëjnë me likuidimin e një ndërmarrjeje sipas autorizimit administrues të Agjencisë dhe paditë për anulimin e transaksioneve të ndonjë ndërmarrjeje që i është nënshtruar procedurës së likuidimit, siç është paraparë në nenin 9.4 të Rregullores nr. 2002/12;

(g) Të gjitha kërkesat dhe aplikacionet që kanë të bëjnë me riorganizimin apo ristrukturimin e ndërmarrjeve në pajtim me Rregulloren nr. 2005/48, të ndryshuar kohë pas kohe.

(h) Me kërkesë të Agjencisë, zbatim i kompetencave të Agjencisë në pajtim me Rregulloren nr. 2002/12;

(i) Ankesat nga aktgjykimet dhe vendimet që i kanë nxjerrë gjykatat e Kosovës për çështjet e përfshira në këtë nen;

(j) Çështjet ku anëtarët ndërkombëtarë të Bordit të drejtorëve kanë pezulluar vendimin e institucionit pasardhës të AKM-së. Çështjet e tilla do të zgjidhen me urgjencë.

(k) Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nga aktvendimet ose vendimet që i kanë nxjerrë gjykatat në Kosovë për çështjet e përfshira në këtë nen dhe

(l) Çështje të tjera që mund të caktohen me ligj.

Çdo panel gjykues i Dhomës së Posaçme do të ketë kompetenca primare për njërin nga çështjet e paraqitura në nenin 3.2 (a) deri ((e) ashtu siç është përcaktuar me rregullat procedurale të shpallura me nenin 7 të kësaj Rregulloreje.

4.2 Pavarësisht nga neni 4.1, një panel gjykues mund t'ia përcjellë paditë e veçanta, kategoritë e padive ose pjesë të tyre, cilëso gjykate që ka juridiksion për atë çështje sipas ligjit në fuqi. Asnjë gjykatë në Kosovë nuk mund të ushtrojë juridiksion për paditë apo të zgjidhë rastet që përfshin lëndën e përshkruar në nenin 4.1, përveç nëse një padi e tillë i është referuar asaj në pajtim me këtë nen.

4.3 Ndaj aktvendimit apo vendimit të gjykatës, të cilës i është përcjellë lënda nga një panel gjykues i Dhomës së Posaçme në pajtim me nenin 4.2, mund të ushtrohet ankesë vetëm

në panelin gjykues të Dhomës së Posaçme, përveç rasteve kur paneli gjykues vendos ndryshe, në pajtim me rregullat procedurale të shpallura me nenin 7. Neni 4.4 zbatohet për çdo aktvendim të mëvonshëm të nxjerrë nga paneli gjykues.

4.4 Paneli i apelit do të ketë juridiksion ekskluziv për të vendosur mbi ankesat ndaj çdo aktvendimi ose vendimi të panelit gjykues të Dhomës së Posaçme, përveç nëse me këtë Rregullore parashihet ndryshe.

4.5 Asnjë dispozitë e këtij neni nuk i cenon të drejtat e paditësve për të paraqitur jashtë Dhomës së Posaçme paditë e tyre, të cilat nuk përfshijnë lëndën e përshkruar në nenin 4.1.

4.6 Pas paraqitjes së kërkesës nga pala apo me iniciativë të veten, Dhoma e Posaçme mund të tërheqë cilëndo padi që është në gjykim e sipër në një gjykatë në Kosovë, palë e së cilës është një ndërmarrje në panelin gjykues të Dhomës së Posaçme.

#### Neni 5 Paditësit dhe të paditurit

5.1 Paditësit në procedurat pranë Dhomës së Posaçme kufizohen vetëm në:

- (a) Personat të cilët kërkojnë pronësi ose të drejta të tjera pronësore, kreditorët dhe personat e tjerë, të cilët kërkojnë interes të drejtpërdrejtë financiar në lëndën e asaj padie;
- (b) Agjencinë;
- (c) Ndërmarrjet apo korporatat që janë nën autoritetin administrativ të Agjencisë dhe
- (d) Personat tjerë që Dhoma e Posaçme i konsideron të nevojshëm për gjykimin e tërësishëm dhe të plotë të rastit nga ajo.

5.2 Të paditurit në procedurat gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme do të kufizohen në:

- (a) Agjencinë, në emër të saj, lidhur me ndonjë nga paditë e përshkruara në nenet 4.1(a), (b) dhe (e);
- (b) Një ndërmarrje a korporatë, që ka qenë përpara ose që aktualisht është nën kontrollin administrativ të Agjencisë, lidhur me ndonjë nga paditë e përshkruara në nenet 4.1(c) dhe (d);
- (c) Agjencinë si administruese, personat tjerë apo ndërmarrja e përfshirë në mënyrë aktive në likuidimin ose riorganizimin e një ndërmarrje sipas Rregullores nr. 2005/48. lidhur me një padi ose kërkesë të përshkruar në nenet 4.1 (f) dhe (g);

(d) Personat që i nënshtrohen padisë nga Agjencia të përshkruar në nenet 4.1 (f) dhe (h) dhe

(e) Personat tjerë që Dhoma e Posaçme i konsideron të nevojshëm për gjykimin e tërësishëm dhe të plotë të rastit nga ajo.

#### Neni 6

##### Afati i depozitimit të padive për kundërshtimin e vendimeve apo veprimeve të Agjencisë

6.1 Paditësi mund të depozitojë vetëm padinë për kundërshtimin e një vendimi ose një veprimi të Agjencisë brenda nëntë (9) muajve nga: (a) data kur paditësi i tillë ka ditur ose po të kishte treguar kujdesin e duhur ka qenë e arsyeshme të dijë për vendimin a veprimin e Agjencisë dhe (b) data kur Dhoma e Posaçme njofton publikisht se është në gjendje të pranojë padi.

6.2 Dispozitat e parashtruara në nenin 6.1 zbatohen pas njoftimit paraprak të Agjencisë nga ana e paditësit në pajtim me nenin 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12.

6.3 Personi i paditur nga Agjencia, ndërmarrja apo korporata, mund të bëjë kundërpadi ndaj Agjencisë, ndërmarrjes ose korporatës, brenda afatit kohor të përcaktuar me ligjin në fuqi. Neni 30.2, i Rregullores nr. 2002/12 nuk vlen për një kundërpadi të tillë.

#### Neni 7

##### Rregullat procedurale të Dhomës së Posaçme

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nxjerr rregulla për udhëheqjen e procedimit gjyqësor nga Dhoma e Posaçme me anë të një urdhërese administrative. Rregullat e tilla i ofrojnë palës një mundësi kuptimplote për gjykimin e padisë së tij në mënyrë të paanshme dhe transparente, duke përfshirë edhe shqyrtimin gjyqësor të aktvendimit të tillë, brenda një afati të arsyeshëm kohor, në përputhje me normat e përcaktuara sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe duke respektuar në tërësi standardet e përgjithshme të pranuar ndërkombëtarisht.

#### Neni 8

##### Paraqitja e provave dhe zhvillimi i seancave

8.1 Dhoma e Posaçme mund të urdhërojë çdo person në Kosovë që të paraqesë dokumente, të dëshmojë ose të ofrojë të dhëna të nevojshme përkatëse për gjykimin e një lënde, në pajtim me rregullat procedurale që do të shpallen sipas nenit 7.

8.2 Paneli gjykues i Dhomës së Posaçme mund t'ia delegojë kompetencat për zhvillimin e seancave gjyqarorit të vetëm ndërkombëtar apo nën panelit të përbërë prej dy anëtarëve të tij, njëri prej të cilëve duhet të jetë gjykatës ndërkombëtar. Aktgjykimet dhe vendimet e marra nga gjyqtari i vetëm apo nga nën paneli do të konsiderohen se janë nxjerrë nga paneli gjykues, përveç nëse me urdhrin me të cilin rasti i delegohet gjyqtarit të vetëm apo nën panelit kërkohet që paneli gjykues të merr vendim apo aktgjykim.

Neni 9  
Aktvendimet, vendimet dhe ankesat

9.1 Dhoma e Posaçme i nxjerr vendimet brenda dy muajve, pas përfundimit të procesit gjyqësor. Shqyrtimet e paneleve gjyqësore dhe panelit të apelit mbesin të pashpalosura.

9.2 Të gjitha aktgjykimet dhe vendimet e Dhomës së Posaçme të cilët nuk merren nga një gjyqtar i vetëm do të miratohen nga shumica e votave.

9.3 Aktgjykimet dhe vendimet bëhen me shkrim dhe duhet të:

- (a) përmbledhin rrjedhën faktike dhe procedurale të procesit gjyqësor;
- (b) paraqesin gjetjet faktike dhe arsyet ligjore të panelit për aktgjykimet dhe vendimet e tij dhe
- (c) theksojnë bazën faktike dhe ligjore të kompensimit, nëse ka, për të cilin pala fituese ka të drejtë, në pajtim me dispozitat e nenit 10.

9.4 Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë aktgjykim apo vendim pa zhvilluar seancë për marrjen e provave dhe dëshmime:

- (a) nëse paditësi ka dorëzuar një padi për të cilën nuk mund të jepet asnjë kompensim sipas ligjit, duke i pranuar si të vërteta pretendimet në kërkesën e paditësit ose
- (b) nëse, pasi palëve t'u jetë siguruar kohë e mjaftueshme për të paraqitur dëshmi të dokumentuara, Dhoma e Posaçme vendos se nuk ka mbetur asnjë kontest i vërtetë i fakteve materiale të nevojshme për ta zgjidhur lëndën.

9.5 Aktgjykimi apo vendimi i panelit gjykues i dërgohet palëve brenda tridhjetë (30) ditësh nga miratimi. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e tij pala mund të paraqesë ankesë në panelin e apelit për rishqyrtim të aktgjykimit apo vendimit të tillë. Nëse paraqitet ankesë kundër vendimit, duke përfshirë edhe aktgjykimin e nxjerrë në pajtim me nenin 4.3, paneli i apelit së pari vendos nëse vendimi apo aktgjykimi ndaj të cilit është paraqitur ankesë meriton të rishqyrtohet. Nëse paneli i apelit vendos të mos e rishqyrtojë vendimin apo aktgjykimin e nxjerrë në pajtim me nenin 4.3 të panelit të apelit, vendimi apo aktgjykimi i tillë merr formën e prerë. Nëse paneli i apelit e rishqyrton aktgjykimin apo vendimin, mund të vendosë që ta konfirmojë, anulojë ose ndryshojë aktgjykimin apo vendimin e marrë nga paneli gjykues.

9.6 Aktgjykimet dhe vendimet i vihen në dispozicion publikut.

9.7 Aktgjykimi apo vendimi i panelit të apelit i dërgohet palëve brenda tridhjetë (30) ditësh. Aktgjykimet dhe vendimet e panelit të apelit janë të formës së prerë dhe mund të ekzekutohen menjëherë.

Neni 10  
Mjetet juridike



10.1 Kompetencat e Dhomës së Posaçme për të dhënë vendime zhdëmtimi i nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara në këtë nen.

10.2 Vendimet kundër një ndërmarrjeje a korporate ekzekutohen vetëm në rastet kur prona është në pronësi të ndërmarrjes ose të korporatës së caktuar, duke përfshirë çfarëdo prone të asaj ndërmarrjeje a korporate e cila mbahet në mirëbesim nga Agjencia.

10.3 Vendimet me të cilat njihet një e drejtë, titull ose interes për ndonjë pasuri të veçantë, që është në pronësi, në posedim ose në kontrollin e një ndërmarrjeje a korporate, ekzekutohen kundër kësaj pasurie, vetëm nëse ndërmarrja apo korporata e ka mbajtur të drejtën, titullin ose interesin mbi atë pasuri, deri në datën kur është nxjerrë vendimi për zhdëmtimin. Kur një e drejtë, titull ose interes i tillë është bartur tek pala e tretë duke vepruar në mirëbesim në përputhje me vendimin e Agjencisë, në pajtim me nenet 8 ose 9 të Rregullores nr. 2002/12, pala gjyqituese gëzon të drejtën për të marrë një kompensim në të holla të barazvlefshëm me vlerën e drejtë të tregut të asaj pasurie. Shuma e kompensimit do të llogaritet në bazë të vlerës së transaksionit të drejtuar nga Agjencia dhe ku përfshihet pasuria në fjalë. Gjykata gjithashtu mund të dëmshpërblejë nëse e konsideron të duhur sipas rregullave procedurale të shpallura me nenin 7. Çdo vendim për kompensim ose kompensim dhe dëmshpërblim ka prioritet mbi paditë e pasiguruara ndaj korporatës së tillë.

10.4 Vendimet ndaj Agjencisë, në cilësinë e saj të drejtpërdrejtë i nënshtrohen dispozitave të nenit 18 të Rregullores nr. 2002/12.

10.5 Asnjë pale nuk duhet t'i akordohen mjete juridike në dobi të saj nëse kjo gjë kërkon anulimin e një transaksioni ose shfuqizimin e një kontrate të lidhur me një palë të tretë që ka vepruar në mirëbesim dhe është përmbushur plotësisht nga Agjencia, në pajtim me kompetencat e saj sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12.

10.6 Dhoma e Posaçme mund të urdhërojë mjete juridike të përkohshme në pajtim me rregullat procedurale, që do të shpallen në përputhje me nenin 7 të kësaj Rregulloreje.

#### Neni 11 Shpenzimet

Çdo panel gjykues i Dhomës së Posaçme vendos lidhur me shpenzimet e proceseve gjyqësore, të atij paneli, duke përfshirë pagesat e arsyeshme dhe shpërblimin e avokatit, që bëhen lidhur me ndjekjen e padisë ose të kundërpadisë, në pajtim me rregullat procedurale të cilat do të shpallen në përputhje me nenin 7. Aktgjykimi apo vendimi i panelit të apelit përfshin alokimin e shpenzimeve të mbarë procedurës, duke përfshirë edhe shpenzimet për procedurën pranë panelit gjykues.

#### Neni 12 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 13  
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 14  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 31 mars 2008, kur edhe rregullat procedurale të shpallura me nenin 7 do të përshtaten ashtu si duhet.

Joachim Rucker  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm